



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 806 S.P/889 Regj.Them

Nr. Vendimi 1073

Datë Regj. 17.01.2022 S.P / 15.02.2022 Regj.Them

Datë Vendimi 20.04.2022

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARE: Oltjona GOXHA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Silvi Xhakolli**, në Tiranë, sot më datë **20.04.2022**, i dha fund shqyrtimit gjyqësor me dyer të hapura të kërkesës penale Nr. 806/889 Regj.Them., datë e ardhjes së dosjes pranë gjyqtarës 31.01.2022 që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Ndini Tavani**.

I PANDEHUR: **Enea Kapedani**, i biri i Robert dhe i Irena, i datëlindjes 05.06.2000, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “Vath Koreshi”, Nd.5, H.1, me arsim të lartë në vazhdim, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar, me shtetësi shqiptare, i identifikuar nga Gjykata me letërnjoftimin me Nr.Personal K00605066F, me datë lëshimi 22.07.2016, e vlefshme për identifikim, hetuar me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”, përfaqësuar në gjykim nga Av.Arbër Hoxha, me nr. 4252 License dhe Nipt L01721002R, Dhoma e Avokatisë Tiranë (i zgjedhur me deklaram).

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”.

BAZA LIGJORE: Neni 283/1 i Kodit Penal.

I PANDEHUR: **Bledar Musaj**, i biri i Behat dhe i Zylfie, i datëlindjes 07.04.1983, lindur në Lushnjë dhe banues në Tiranë, lagjia “Ali Demi”, rruga “Vath Koreshi”, P.2, H.1, me arsim të lartë, me profesion avokat, me gjendje civile beqar, me 1 fëmijë në ngarkim, me gjendje gjyqësore i padënuar, me

shtetësi shqiptare, i identifikuar nga Gjykata me pasaportë biometrike me Nr.Personal I30407059E, me datë lëshimi 28.08.2019, e vlefshme për identifikim, hetuar me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, përfaqësuar në gjykim nga Av.Arbër Hoxha, me nr. 4252 License dhe Nipt L01721002R, Dhoma e Avokatisë Tiranë (i zgjedhur me deklaram).

AKUZUAR:Për kryerjen e veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”.

BAZA LIGJORE: Neni 285/a/1 i Kodit Penal.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata, pasi administroi provat, dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët të cilët kërkuan:

Prokurori: “- Deklarimin fajtor të të pandehurit Enea Kapedani, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim. Aplikimin e nenit 406, pika 1 të K.Pr.Penal. Aplikimin e nenit 59 të K.Penal për pjesën e pavuajtur të dënimit të mbetur për të pandehurin Enea Kapedani i cili ka qënë me arrest shtëpie caktuar me vendimin Nr.1263/1 Akti, datë 07.09.2021. Aplikimin e nenit 60/12 të K.Penal që i pandehuri Enea Kapedani t’i nënshtrohet rehabilitimit.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Bledar Musaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Përshtatja e lokalit për drogë” dhe në bazë të nenit 285/a/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me me kohën e vuajtur në paraburgim.

- Në kuptim të nenit 190 të K.Pr.Penal, asgjesimin e lëndës narkotike.

- Shpenzimet paraprake dhe gjyqësore në ngarkim të të pandehurit”.

-Mbrojtësi i të pandehurve: “Jemi dakord me kërkesat e prokurorisë”.

Të pandehurit: “Jemi dakord me avokatin”.

Si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi;

VËREN SE:

I. Procedura, faktet dhe provat.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit Enea Kapedani, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe të pandehurit Bledar Musaj, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a/1 i K.Penal.

2. Gjykata paraprakisht konstatoi se, bazuar në nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj gjykate gjykimi i saj.

3. Në seancë paraprake, nga ana e të pandehurve dhe mbrojtësit të tyre, u paraqit kërkesë për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Gjykata, si shqyrtoi provat e ndodhura në fashikullin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurve Enea Kapedani dhe Bledar Musaj, konstatoi se, nga ana e të pandehurve dhe mbrojtësit të tyre, nuk u kërkuan të deklaroheshin akte të pavlefshme apo prova të pa përdorshme. Njëkohësisht, nga gjykata nuk u konstatuan kryesisht akte absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 128/a të K.Pr.Penale, apo prova të papërdorshme. Gjithashtu, gjykata konstatoi se provat në ngarkim të të pandehurit ishin të plota dhe çështja penale mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, ndaj në referim të neneve 332/dh gërma c) dhe 405 të K.Pr.Penale vendosi të pranonte kërkesën e të pandehurve dhe mbrojtësit të tyre për të proceduar me gjykim të shkurtuar.

1. **Nga shqyrtimi tërësor i akteve të këtij procedimi penal rezulton se:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr.5319, datë 23.07.2021, në ngarkim të të pandehurit Enea Kapedani, akuzuar për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe të pandehurit Bledar Musaj, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Përshtatja e lokalit për përdorim droge*”, parashikuar nga neni 285/a/1 i K.Penal.

4. Nga aktet që ndodhen në fashikullin hetimor dhe shpjegimet e prokurorit, rezulton se, në datë 22.07.2021, në orën 23:40, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Nr. 1, është ushtruar kontroll në ambjentet e lokal “Mai a letto”, i ndodhur në rrugën “Petro Nini Luarasi”. Gjatë kontrollit, mbi një tavolinë druri, është konstatuar një enë metalike në ngjyre gri, mbi të cilën gjendeshin 4 qese të vogla plastike të mbështjella me djegie në majën e tyre, brenda të cilave kishte material pluhur në ngjyrë të bardhë, i dyshuar si lëndë narkotike e llojit “kokainë”.

5. Pluhuri i bardhë i gjetur në enën metalike si dhe qeset e vogla plastike janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe pas peshimit kanë rezultuar me peshë 2.2 (dy pikë dy) gram me gjithë ambalazh.

6. Në vijim të veprimeve të para hetimore janë pyetur si persona që kanë dijeni mbi ngjarjen shtetasit Dritan Lika dhe Danjel Domi, me detyrë punonjes policie në Komisariatin e Policisë

Nr.1. Tiranë, të cilët ndër të tjera kanë deklaruar se kanë shkuar në lokalin “Mai a Letto” në ndihmë të kolegëve e tyre të seksionit të Krimeve. Pasi kanë hyrë brenda në lokal, kanë konstatuar shtetasit Enea Kapedani dhe Bledar Musaj. Me pas kanë ushtruar kontroll në ambjentet e lokalit ku kanë gjetur sasi lënde narkotike të përshkruar si mësipër.

7. Sipas aktit të ekspertimit kimik Nr. 10787, datë 22.10.2021 rezulton se: *“Analiza me GC/MS për materialet, objekt ekspertimi, treguan për praninë e kokainës. Pesha në total pa ambalazh e materialeve, objekt ekspertimi, është 1.757 gram”.*

8. Sipas aktit të ekspertimit kimik Nr.9876, datë 30.09.2021 rezulton se: *“Analiza me GC/MS për mbetjet në objektin metalik treguan për praninë e kokainës”.*

9. Sipas aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor Nr.1895, datë 18.08.2021, është konkluduar se: *“Në mostrën e urinës së marrë shtetasit Enea Kapedani u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të Cocainës në organizmin e njeriut”.*

10. Sipas aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor Nr. 1897, datë 19.08.2021, është arritur në përfundimin se: *“Në mostrën e urinës së marrë shtetasit Bledar Musaj u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të Cocainës në organizmin e njeriut”.*

11. I pyetur në cilësinë e personit nën hetim shtetasi Enea Kapedani ka deklaruar se: *“unë punoj si banakier dhe kamarier në këtë lokal prej 5 muajsh. Dje, rreth orës 23:50, ka ardhur policia për kontroll në këtë lokal dhe gjatë kontrollit kanë gjetur disa doza kokaine dhe një enë metalike. Në momentin që ka ardhur policia unë keto sende i kam futur poshtë një shilteje të këndit ku ulen klientët në lokal. Jam përdorues i lëndës narkotike prej 4 vitesh por me ndërprerje. Unë këtë sasi lënde narkotike e kam blerë në qendër të Laprakës tek nje person të cilin nuk e njoh me gjeneralitetet por është rracë e bardhë dhe rreth moshës 25 vjec, i kam dhënë 12000 lekë dhe ai më ka dhënë këtë sasi lënde narkotike. Unë nuk kam konsumuar lëndë narkotike herë të tjera në këtë ambjent dhe pronari im Bledar Musaj nuk ka pasur dijeni për këtë sasi lënde narkotike që është gjendur pasi do të më kishte hequr nga puna. Madje dje ai nuk ka qënë në lokal dhe ka mbërritur pak minuta pasi ka hyrë policia kontroll”.*

12. I pyetur në cilësinë e personit nën hetim shtetasi Bledar Musaj ka deklaruar se: *“lokali që ka gjetur policia lëndën narkotike është i imi të cilin e kam marrë me qira prej afro 1 viti. Unë*

jam dhe menaxher i këtij ambjenti ku punëtor kam vetëm shtetasin Enea Kapedani, të cilin e kam gjithë ditën në punë pasi është lokal që nuk ka shumë xhiro. Dje, gjatë mbasdites, kam shkuar në lokal për të parë si po funksiononte puna dhe pasi kam ndenjur pak, jam larguar për disa punë të miat. Përpara se të shkonte ora 12 e natës unë kam shkuar në lokal për të marrë xhiron e turnit të dytë dhe aty kam parë se ishin futur punonjës policie për kontroll dhe kanë pyetur kush është pronari i lokalit dhe unë jam përgjigjur se jam unë. Më kanë kontrolluar dhe nuk më kanë gjetur ndonjë send të kundërligjshëm. Aty kam mësuar se punonjësit e policisë kanë gjetur lëndë narkotike kokainë dhe një pjatë metalike për të cilën unë nuk kisha dijeni se si mund të gjendeshin aty. Nuk i kam parë se çfarë sendesh ka gjetur policia pasi unë kam hyrë në lokal mbasi policia kishte bërë kontroll dhe nuk më kanë dhënë mundësinë që të shikoj se çfarë është gjendur në lokal. Di të them që në lokalin tim nuk është konsumuar ndonjëherë lëndë narkotike. Unë nuk kam dijeni nëse Enea përdor apo jo lëndë narkotike, unë e kam marrë si punëtor në këtë ambient për të shërbyer në banak dhe për t'u shërbyer klientëve”.

13. Në rrethanat e mësipërme shtetasit Enea Kapedani i është komunikuar akuza për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe shtetasit Bledar Musaj i është komunikuar akuza për kryerjen e veprës penale “*Përshtatja e lokalit për përdorim droge*”, parashikuar nga neni 285/a/1 i Kodit Penal.

14. Sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën me objekt si në hyrje të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Gjykatës.

15. Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Prandaj, në çështjen konkrete, Gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet.

16. Në lidhje me akuzën ndaj të pandehurit Enea Kapedani për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Kjo dispozitë përcakton se: “*Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet*”. **Objekti** i kësaj vepre penale mund të identifikohet si i dyfishtë në objekt parësor dhe në objekt dytësor. *Objekti parësor* janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit e lëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsa përgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe. Qëllimi i ligjvënësit në përjashtimin e përdoruesve ka qenë duke i parë ata si viktimë të veprës penale dhe jo si subjekte të kryerjes së saj. Ndërsa *objekti dytësor* i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike, jetës dhe shëndetit të njeriut. Në rastin konkret rezulton që ky objekt është cenuar nga i pandehuri Enea Kapedani, i cili mbante, në kundërshtim me ligjin, sasinë prej 1.757 gram lëndë narkotike e llojit “Kokainë”.

2. **Nga ana objektive** legjislatori ka parashikuar se kjo vepër penale mund të kryhet me mënyra të ndryshme si: përmes shitjes, ofrimit për shitje, dhënies ose marrjes në çdo forme, transportimit, dërgimit, dorëzimit, **mbajtjes**, shpërndarjes, apo tregtimit *në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tij*. Kjo do të thotë se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jetë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike.

17. Gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, t’i krijojë gjykatës bindjen “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*” se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: “*Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë*”. Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, *në çështjen Giuliani dhe Gaggio*

kundër Italisë shprehet se: “Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktimeve përkuese, mjaftueshmërisht të forta dhe të qarta ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.”.

18. Gjithashtu, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: “1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. **Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.**”.

19. Në rastin konkret rezulton e provuar se në datë 22.07.2021, në orën 23:40, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Nr. 1, është ushtruar kontroll në ambjentet e lokal “Mai a letto”, i ndodhur në rrugën “Petro Nini Luarasi”. Gjatë kontrollit, mbi një tavolinë druri, është konstatuar një enë metalike në ngjyre gri, mbi të cilën gjendeshin 4 qese të vogla plastike të mbështjella me djegie në majën e tyre, brenda të cilave kishte material pluhur në ngjyrë të bardhë, i dyshuar si lëndë narkotike e llojit “kokainë”. Pasi u bë sekuestrimi i lëndës të dyshuar narkotike të llojit Kokainë, u bë peshimi i saj dhe rezultoi me peshë të përgjithshme 2.2 (dy pikë dy) gram dhe me peshë pa ambalazh 1.757 gram.

20. Gjatë hetimeve është pyetur në cilësinë e personit nën hetim shtetasi Enea Kapedani, i cili ka deklaruar se lënda narkotike ishte e tij dhe e kishte blerë për përdorim personal pasi prej 4 vitesh është përdorues i kokainës, me ndërprerje.

21. Sipas aktit të ekspertimit kimik Nr. 10787, datë 22.10.2021 rezulton se: “Analiza me GC/MS për materialet, objekt ekspertimi, treguan për praninë e kokainës. Pesha në total pa ambalazh e materialeve, objekt ekspertimi, është 1.757 gram”.

22. Sipas aktit të ekspertimit kimik Nr.9876, datë 30.09.2021 rezulton se: “Analiza me GC/MS për mbetjet në objektin metalik treguan për praninë e kokainës”.

23. Sipas aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor Nr.1895, datë 18.08.2021, është konkluduar se: “Në mostrën e urinës së marrë shtetasit Enea Kapedani u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të Cocaines në organizmin e njeriut”.

24. Fakti penal në ngarkim të të pandehurit rezulton i provuar me: “*Procesverbalin e kapjes në flagrancë. Procesverbalin e sekuestrimit të sendeve. Procesverbali i kontrollit personal. Akti i ekspertimit toksikologjik dhe kimik të lëndës. Deklarimet e të pandehurit Enea Kapedani. Deklarimet e personave që kanë dijeni për veprën penale, si dhe në tërësi nga materialet hetimore të procedimit penal nr.5319 të vitit 2021*”.

25. Në këto kushte, Gjykata çmon se, në çështjen objekt gjykimi, provohet **tej çdo dyshimi të arsyeshëm** se, nga ana e të pandehurit, janë plotësuar elementët e anës objektive të veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

3. **Subjekti.** Personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kriterë ekskluzive ligjore (condicio sine qua non): *i) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ii) të jetë i përgjegjshëm për veprën penale në momentin e kryerjes së saj.* Në rastin konkret, i pandehuri Enea Kapedani, në kohën e kryerjes së veprës ka qenë madhor (ai është i vitëlindjes 2000), po ashtu sikurse u theksua në paragrafin e mësipërm, ai është i përgjegjshëm para ligjit. Si rrjedhojë, ai ka qenë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe volitive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe t’a kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri Enea Kapedani është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

4. **Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale “*nullum crimen, nulla poena sine culpa*”, është element i përgjegjësisë penale që parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal. Ai përmban në vetvete dy momente: *atë intelektual* dhe *atë që lidhet me vullnetin*. Momenti intelektual tregon nëse subjekti nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm të veprës, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave të dëmshme, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim të kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Nëpërmjet individualizimit të këtyre dy momenteve, intelektual dhe volutiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë.

26. Për të qenë para veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Shkaqet apo motivet që e kanë

shtyrë të pandehurin të kryejë këtë vepër penale nuk kanë rëndësi për cilësimin ligjor të veprimeve të të pandehurit, por mbahen parasysh nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Në rastin konkret, i pandehuri ka vepruar me dashje duke mbajtur, në mënyrë të kundërligjshme, lëndën narkotike të llojit Kokainë.

27. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri Enea Kapedani, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

-Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit për të pandehurin Enea Kapedani.

28. Dënimi penal në të drejtën penale kupton atë masë shtrënguese, që zbatohet nga shteti nëpërmjet Gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer vepër penale. Kriteret dhe parimet themelore që duhet të zbatojë Gjykata në caktimin e një dënimi të caktuar, janë të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme, pikërisht në nenin 47 të Kodit Penal. Konkretisht, në këtë dispozitë, sanksionohet se: “*Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese*”.

29. Në mbështetje të parimeve të pasqyruara më lartë, konkludohet se Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, i referohet në rradhë të parë llojit të dënimit dhe kufijve të vendosur në dispozitën ligjore konkrete në bazë të së cilës është bërë cilësimi i veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri.

30. Gjykata, në përcaktimin e llojit dhe masës konkrete të dënimit, në kuadër të respektimit të parimit të individualizimit të dënimit, duhet të vlerësojë këto elementë:

- Llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal (në rastin konkret, parashikohet dënim me burgim nga 5 deri në 10 vjet);
- Rrezikshmërinë e veprës penale (në rastin konkret, vepra penale në ngarkim të të pandehurit paraqet rrezikshmëri shoqërore);
- Rrezikshmërinë e autorit të veprës penale (në rastin konkret autori nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore pasi ai nuk ka qenë i dënuar më parë);
- Shkallën e fajit (vepra penale është kryer me dashje që është shkalla më e rëndë e fajësisë);

- Rrethanat lehtësuese dhe rënduese (rrethana rënduese në rastin konkret nuk ka).

31. Në lidhje me rrethanat lehtësuese Gjykata mban parasysh rrethanat e mëposhtëme që i konsideron të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit:

- faktin që i pandehuri Enea Kapedani është përdorues i lëndës narkotike të llojit Kokainë;
- si në fazën e hetimeve ashtu edhe në fazën e gjykimit, i pandehuri ka pranuar akuzën dhe është shfaqur i penduar;
- faktin që nuk ka qenë ndonjëherë i dënuar;
- faktin që i pandehuri nuk i është shmangur hetimit dhe gjykimit dhe ai ka qenë bashkëpunues;
- moshën e re të pandehurit;
- faktin që është në vazhdim të shkollës së mesme dhe nevojën për të mos ndërprerë proceset mësimore dhe edukative;
- sasinë e vogël të lëndës narkotike.

32. Sa më sipër, në analizë të të gjitha rrethanave dhe fakteve të kryerjes së veprës penale, të personalitetit të të pandehurit, Gjykata konkludon në lidhje me individualizimin gjyqësor të masës së dënimit, se në rastin konkret ndaj të pandehurit Enea Kapedani duhet të caktohet dënimi me 5 (pesë) vjet burgim për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Gjykata thekson se kjo masë dënimi, është një masë e përshtatshme për të pandehurin, në përputhje me veçoritë e tij dhe të veprës penale konkrete, si dhe me rrethanat në të cilat vepra penale është kryer, duke synuar ruajtjen e një raporti të drejtë mes ndëshkimit të fajtorit dhe mbrojtjes së shoqërisë. Gjithashtu, Gjykata në caktimin e një masë të tillë dënimi ndaj të pandehurit mban parasysh edhe parimin se ashpërsia e një penalteti për një vepër penale të kryer, duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale me ashpërsinë e veprës penale.

33. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 (një e treta) e dënimit duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Enea Kapedani me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

- ***Lidhur me caktimin e alternativës së dënimit me burgim për rastin konkret.***

34. Në kreun VII të Kodit Penal nga nenet 58 deri në nenin 65 të tij, parashikohen “*Alternativat e dënimit me burgim*”. Në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, Gjykata e gjen me vend që paraprakisht të theksojë se alternativat e dënimit me burgim nuk janë dënime të reja, pasi dënimi në rastin konkret është vetëm një dhe konkretisht, dënimi me burgim. Këto alternativa të vuajtjes së dënimit me burgim janë vetëm forma apo mënyra të veçanta të vuajtjes së dënimit me burgim.

35. Aplikimi i alternativave të dënimit me burgim, lidhet në mënyrë të pazgjydhshme me ekzistencën e vetë dënimit (*Parimi “Nulla poena sine lege”*), si dhe me parashikimin ligjor të tyre. Pra, ashtu sikundër nuk mund të zbatohet një dënim penal që nuk është parashikuar në ligj, nuk mund të aplikohet një alternativë (sanksion në interes të komunitetit) e parashikuar në ligj.

36. Një nga alternativat e dënimit me burgim është “*Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë*”. Kështu, në nenin 59 të Kodit Penal parashikohet shprehimisht se: “*Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhëroj, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga Gjykata kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: **Së pari**: Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se pesë vjet burgim; **Së dyti**: Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim: i pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore; i pandehuri është i mitur apo i moshuar; - i pandehuri ka kushte mendore apo shëndetësore të veçanta; i pandehuri ka detyrime për punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional; i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familje; i pandehuri e ka kryer veprën në kushtet e disa rrethanave lehtësuese; i pandehuri ka pasur një sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale. Nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal rezulton, se këto rrethana janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

37. Duke i'u kthyer rastit konkret, Gjykata vlerëson se i pandehuri Enea Kapedani i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vendosjen e tij në provë, për këto arsye: **Së pari**, i pandehuri u dënua përfundimisht me me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim. **Së dyti**, i pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore. Ai nuk rezulton të ketë qenë i dënuar më parë. **Së treti**, mban parasysh sjelljen e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale. Kështu i pandehuri ka pranuar faktin dhe ka shfaqur pendesë për veprimin e kryer. Kjo tregon një sjellje të mirë të të pandehurit pas kryerjes së veprës penale. **Së katërti**, i

pandehuri ka detyrime për arsimimin pasi është në vazhdim e sipër të arsimit të mesëm. **Së pesti**, mban parasysh faktin që i pandehuri është hetuar me masë sigurimi “Arrest në shtëpi” dhe ka qenë korrekt në zbatimin e saj, duke vuajtur në këtë mënyrë dhe një pjesë të burgimit **Së pesti**, sipas standardeve ndërkombëtare të vendosura, përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç është shprehur edhe Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm “kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës”, dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë. Të gjitha këto rrethana i krijojnë bindjen Gjykatës se, ekzekutimi i vendimit me burgim dhe izolimi i mëtejshëm për 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj nga shoqëria i të pandehurit Enea Kapedani, nuk është i nevojshëm.

38. Për sa i përket afatit të provës në paragrafin 4 të nenit 59 të K.Penal parashikohet se: “*Afati i provës me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet...*”. Në kushtet kur për të pandehurin Enea Kapedani gjykata dha një dënim me burgim 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj, ai duhet të vendoset në provë për një periudhë kohe prej 3 (tre) vitesh, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë veprë tjetër penale.

39. Në zbatim të nenit 60/9 të K.Penal detyrohet i pandehuri **Enea Kapedani** të mos shoqërohet me persona të dënuar.

40. Në zbatim të nenit 60/12 të K.Penal detyrohet i pandehuri **Enea Kapedani** t’i nënshtrohet një trajtimi apo program mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin lëndëve narkotike.

41. Nëse i pandehuri Enea Kapedani nuk përmbush detyrimet e vendosura nga Gjykata, atëherë ndaj tij do të veprohet sipas nenit 62 të Kodit Penal nën titullin “**Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës**”.

42. Në zbatim të nenit 190 të K.Pr.Penale, lënda narkotike e sekuestruar me procesverbalin e datës 23.07.2021, në pjesën e mbetur pas aktit të ekspertimit, të asgjësohet.

43. Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale, deklarohet heqja e masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr. 1263/1 Akti, datë 07.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. **Në lidhje me akuzën ndaj të pandehurit Bledar Musaj** për kryerjen e veprës penale “*Përshtatja e lokalit për përdorim droge*”, parashikuar nga neni 285/a/1 i K.Penal, Gjykata vlerëson se veprimet e të pandehurit Bledar Musaj, të pretenduara nga organi i akuzës, nuk përmbajnë elementët e figurës së veprës penale për të cilën ai është akuzuar dhe ai duhet të deklarohet i pafajshëm në zbatim të nenit 388/d të K.Pr.Penale.

1. Gjykata vëren se, përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t’iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë, organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal. Legjislatori duke konkretizuar parimin e ligjshmërisë të shprehur në nenin 1, në pjesën e posaçme të Kodit Penal, ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse të dënimeve për to.

2. Sa më sipër, sipas të drejtës sonë penale, e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar veprë penale, të parashikuar nga ligji penal. Për këtë arsye, bashkëekzistenca e njëkohshme e elementeve të figurës së veprës penale ka një rëndësi të madhe sepse lidhet domosdoshmërisht me zbatimin e parimit të ligjshmërisë.

44. Neni 285/a/1 i Kodit Penal se: “*Përshtatja ose lejimi për përshtatjen e lokalit, banesës, mjeteve motorike dhe të çdo mjete tjetër publik ose privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim gjer në pesë vjet*”. **Objekti** i kësaj veprë penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të parandaluar dhe luftuar përhapjen e përdorimit të lëndëve narkotike, kundër atyre individëve të cilët e mbështesin këtë veprimtari të paligjshme duke përshtatur dhe lejuar pasurinë private për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca të palejueshme nga ligji. Në rastin konkret nuk rezulton e provuar që ky objekt të jetë cënuar nga i pandehuri Bledar Musaj.

6. **Nga ana objektive**, vepra penale e “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a/1 i K.Penal, kryhet kryhet me veprime ose mosveprime të kundërligjshme, që konsistojnë në “përshtatjen” ose “lejimin” e lokalit apo çdo ambjenti tjetër privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca narkotike ose psikotrope.

45. Në rastin konkret, sikundër rezultoi e provuar, gjatë kontrollit të kryer nga punonjësit e policisë në datë 22.07.2021, në lokalin e të pandehurit Bledar Musaj, i pranishëm ishte vetëm i pandehuri Enea Kapedani, i cili, gjatë deklarimeve të dhëna prej tij, është shprehur se lëndën narkotike e kishte për përdorim personal ndërsa pronari i lokalit i pandehuri Bledar Musaj nuk kishte dijeni për faktin e ndodhjes së lëndës narkotike në lokal. Në të njëjtën linjë vijon edhe qëndrimi i të pandehurit Bledar Musaj i cili ka deklaruar se jo vetëm që nuk ka dijeni për lëndën narkotike të gjetur në lokalin e tij por shprehet se në atë ambient nuk është konsumuar ndonjëherë lëndë narkotike. Deklarimet e të pandehurit Bledar Musaj se nuk ka qënë i pranishëm në momentin e kontrollit të kryer nga policia konfirmohen edhe nga pamjet filmike të administruara të cilat tregojnë se i pandehuri Bledar Musaj ka shkuar më vonë në lokal. Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk rezultoi e provuar që i pandehuri të ketë kryer veprën penale të “Përshtatja e lokalit për përdorim droge” në ndonjë prej formave të saj. Kështu, nuk rezultoi e provuar që i pandehurit Bledar Musaj, me veprime aktive dhe konkrete, të ketë përshtatur lokalin e tij për përdorim droge apo me veprime a mosveprime të ketë lejuar përshtatjen e lokalit për këtë qëllim. Veprimet e të pandehurit Bledar Musaj, që konsistojnë në mbikqyrjen e funksionimit të lokalit, kryerjen e llogarive, tërheqjen e xhiros sipas turneve, janë veprime të natyrës menaxheriale të cilat i përshtaten cilësisë së tij si pronar dhe menaxher i lokalit. Fakti që i pandehuri është në këtë pozicion nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se ai ka konsumuar veprën penale të “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a/1 i K.Penal përse kohë që nuk vërtetohen me prova bindëse, veprimet konkrete të tij të manifestuara në formën e përshtatjes apo lejimit të përshtatjes së lokalit për përdorim droge. Gjykata është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *“1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”*

46. Në këto kushte, Gjykata çmon se, në çështjen objekt gjykimi, **nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm** se, nga ana e të pandehurit, janë plotësuar elementët e anës objektive të veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a/1 i Kodit Penal.

7. **Subjekti.** Personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (condicio sine qua non): i) *Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ii) të jetë i përgjegjshëm për veprën penale në momentin e kryerjes së saj.* Në

rastin konkret, i pandehuri Bledar Musaj, në kohën e kryerjes së veprës ka qënë madhor (ai është i datëlindjes 1983), po ashtu sikurse u theksua në paragrafin e mësipërm, ai është i përgjegjshëm para ligjit. Si rrjedhojë ai ka qënë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe volitive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe t'a kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri Bledar Musaj është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

8. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, Gjykata vlerëson se për të qënë përpara kësaj vepre penale duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Në rastin konkret, nuk rezulton e provuar që i pandehuri Bledar Musaj, ka dëshiruar dhe ka vepruar në drejtim të arritjes së pasojës kriminale që është përshtatja ose lejimi i përshtatjes së lokalit për përdorim droge. Ana subjektive e veprës penale zbulohet nëpërmjet anës objektive. Veprimet e kryera nga i pandehuri Bledar Musaj në kuadër të cilësisë së tij si pronar dhe menaxher i lokalit manifestojnë dhe vërtetojnë se vullneti dhe qëllimi i të pandehurit ka qënë vetëm përmbushja e detyrave të përditshme të natyrës menaxheriale. Në asnjë prej veprimeve të kryera nga i pandehuri nuk shprehet dashja e tij për të përshtatur lokalin për përdorim drogë apo për të lejuar persona të tjera të përshtatin ambientin e lokalit për përdorim droge. Gjithashtu, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton e provuar dijenia e të pandehurit Bledar Musaj që i pandehuri tjetër Enea Kapedani ishte përdorues i kokainës dhe mbante në këtë ambient lëndë narkotike, sikundër nuk rezulton e provuar dijenia e të pandehurit Bledar Musaj që të ketë lejuar me ndërjegje dhe vullnet, përdorimin e lokalit të tij për konsumim lëndë narkotike.

47. Në këto kushte, Gjykata çmon se, në çështjen objekt gjykimi, **nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm** se, nga ana e të pandehurit, janë konsumuar elementët e anës subjektive të veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a/1 i Kodit Penal.

48. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk provohet që i pandehuri Bledar Musaj e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në mungesë të ekzistencës dhe provueshmërisë, në mënyrë kumulative, të elementë të figurës së veprës penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, Gjykata, konkludon se i pandehuri Bledar Musaj duhet të deklarohet i pafajshëm për veprën penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga neni 285/a/1 i K.Penal, në zbatim të nenit 388/d të K.Pr.Penale, pasi nuk provohet që ai ta ketë kryer atë.

49. Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale, deklarohet heqja e masës së sigurimit personal “Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr. 1263/2 Akti, datë 02.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

-Lidhur me shpenzimet procedurale.

60. Duke qenë se, i pandehuri Enea Kapedani u deklarua fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohet, bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale, shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 375, 379, 390, 403, 405, 406, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe neneve 1/c, 34, 47-50, dhe 283/1 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar,

VENDOSI

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Enea Robert Kapedani** për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 5 (pesë) vite burgim.
2. Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Enea Robert Kapedani** me 3 (tre) vite e 4 (katër) muaj burgim.
3. Në zbatim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet:

-Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim.

-Vënia në provë e të pandehurit **Enea Robert Kapedani** për një periudhë kohe prej 3 (tre) vitesh, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

-Gjatë kohës së provës, i pandehuri **Enea Robert Kapedani** të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë.

-Afati i kohës së provës për të pandehurin **Enea Robert Kapedani** fillon nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.

4. Në zbatim të nenit 60/9 të K.Penal detyrohet i pandehuri **Enea Robert Kapedani** të mos shoqërohet me persona të dënuar.
5. Në zbatim të nenit 60/12 të K.Penal detyrohet i pandehuri **Enea Robert Kapedani** t’i nënshtrohet një trajtimi apo program mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkolit ose lëndëve narkotike.
6. Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale, deklarohet heqja e masës së sigurimit personal “*Arrest në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr. 1263/1 Akti, datë 07.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Bledar Behar Musaj** për kryerjen e veprës penale “*Përshtatja e lokalit për përdorim droge*”, parashikuar nga neni 285/a/1 i K.Penal, pasi nuk provohet të këtë kryer veprën penale.
8. Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale, deklarohet heqja e masës së sigurimit personal “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr. 1263/2 Akti, datë 02.09.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
9. Në zbatim të nenit 190 të K.Pr.Penale lënda narkotike, e sekuestruar me procesverbalin e datës 23.07.2021, në pjesën e mbetur pas aktit të ekspërtimit, të asgjësohet.
10. Shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore të parapaguara nga shteti lihen në ngarkim të të pandehurit Enea Kapedani.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë, sot më datë 20.04.2022.

SEKRETARE GJYQTARE

Silvi XHAKOLLI Oltjona GOXHA

Shpenzime gjyqësore:

Njoftime: 600 lekë

Hetime paraprake: 28.400 lekë